



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raport¹

mbi ecurinë e treguesve që do të monitorojë Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të deeuroizimit

Korrik 2018

¹ Ky Raport publikohet në kuadër të parashikimeve në Memorandumin e Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqytjes Financiare për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare nënshkruar më 18.04.2017, dhe publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Paketa_e_deeuroizimit/

Përmbajtje

I	Hyrje	3
II	Përmbledhje.....	5
III	Ecuria e treguesve.....	6
IV	Konkluzion	12
	Aneksi I: Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit..	13
	Aneksi II: Vrojtimi i kryer për Euron nga Banka Qendrore e Austrisë.	14

I Hyrje

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nënshkruar në datën 18 prill 2017, Banka e Shqipërisë ndërmoi një paketë masash konkrete për të stimuluar përdorimin e monedhës vendase. Paketa e masave, e cila u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në shkurt 2018, përmban tre elemente kryesore: i) diferencimin e rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë; ii) kërkesat më të larta për treguesit e likuiditetit në valutë; iii) ndërgjegjësimin e huamarrësve për rrezikun që paraqet kredia në valutë.

- i. Për të rritur peshën e monedhës vendase dhe njëkohësisht për të zgjeruar maturitetin në strukturën e detyrimeve të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë **vendosi të diferencojë normën e rezervës së detyrueshme²**, për kategoritë e përfshira në bazën e rezervës së detyruar, si vijon:
- 7.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë që kanë një afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj;
 - 5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë që kanë një afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet;
 - 12.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në valutë kur këto zënë nën 50% të totalit;
 - 20% (nga 10% që ishte më parë) për pjesën mbi 50% të totalit të detyrimeve në valutë.

Monitorimi i efektit të masës (i) bëhet nëpërmjet treguesve si më poshtë:

- *raportit të depozitave në valutë, të zhveshur nga efekti i luhatjeve në kursin e këmbimit ndaj totalit të depozitave;*
- *raportit të depozitave me afat deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë;*
- *ecurisë së strukturës së borxhit publik.*

- ii. Për administrimin më të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, Banka e Shqipërisë vendosi **të rrisë kërkesën minimale rregullative për aktivet likuide në valutë³**, në nivelin prej 20% të detyrimeve afatshkurtra. Ndërsa, raporti i aktiveve likuide në lekë do të ruhet në nivelin aktual prej 15%.

² Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 13, datë 07.02.2018, òPër miratimin e normës së rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankatò.

³ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.14, datë 07.02.2018, òPër një ndryshim në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetitò.

Monitorimi i efektit të masës (ii) do të bëhet nëpërmjet:

- *raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, të zhveshur nga efekti i luhatjeve në kursin e këmbimit.*

iii. Për rritjen e **ndërgjegjësimit të huamarrësve** në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë u kërkon bankave⁴ që:

- *të ofrojnë huamarrësit një kredi alternative në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat e tij, në rastin kur klienti aplikon për një kredi në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, si dhe ta pajisin huamarrësin me një shembull ilustrues se si ndryshon kësti i kredisë në rastin e nënçmimit të lekut dhe/ose të rritjes së normës së interesit (me vlera të përcaktuara);*
- *të përfshijnë në kontratat e reja të kredisë në valutë (apo në ato që ristrukturohen rishtas), mundësinë për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e tregut për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet e dakordësuara mes bankës dhe huamarrësit.*

Monitorimi i efektit të masës (iii) bëhet nëpërmjet treguesve:

- *kredisë në valutë ndaj totalit të portofolit, të zhveshur nga efekti i luhatjeve në kursin e këmbimit;*
- *kredisë në valutë, pjesa e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ndaj totalit të portofolit, të zhveshur nga efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit;*
- *rezultateve të vrojtimit të Euros që përgatitet një herë në vit nga Banka Qendrore e Austrisë.*

Efikasiteti i masave do të monitorohet përmes treguesve dhe do të vlerësohet në bazë të ndryshimeve në nivelin e euroizimit të sistemit financiar para dhe pas implementimit të tyre. Rezultatet e këtij vlerësimi, si dhe gjykimi mbi përshtatshmërinë e masave për arritjen e objektivit, që është nxitja e përdorimit më të madh të monedhës kombëtare në ekonomi, do të komunikohen çdo gjashtë muaj përmes publikimit të këtij raporti.

Sikurse theksohet në Memorandum, synimi i Strategjisë nuk është arritja e nivelit zero të përdorimit të monedhave të huaja, pasi niveli i hapjes së ekonomisë sonë me vendet e BE-së e nënkupton praninë e rëndësishme të euros apo monedhave të tjera të huaja në sistemin tonë financiar.

Objektivi është zvogëlimi i shkallës së përdorimit të monedhave të huaja në veprimtarinë e subjekteve, në një nivel që mund të konsiderohet natyral për një ekonomi të ngjashme me atë shqiptare.

⁴ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 07.02.2018, òPër disa ndryshime në rregulloren mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare.

II Përmbledhje⁵


Përdorimi i valutës në sistemin financiar shqiptar mbetet i përqendruar në kredinë për bizneset, depozitat e individëve dhe borxhin e jashtëm të qeverisë.

Depozitat në valutë – Në fund të muajit qershor 2018, depozitat në valutë përbëjnë 53.2% të totalit të depozitave të sektorit privat, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me fundin e vitit 2017. Ndërkohë, depozitat me afat deri në një vit në monedhën vendase kanë njohur rritje duke prekur nivelin prej 87.4%.

Likuiditeti – Në fund të qershorit 2018, aktivet likuide në valutë përbëjnë rreth 32.3% të pasiveve afatshkurtra në valutë, duke shënuar një rënie prej 2.4 pikë përqindjeje krahasuar me gjashtë muaj më parë.

Kreditë – Në fund të periudhës së analizuar, 57.2% e portofolit të kredive janë në valutë. Ndërkohë, pjesa e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, përbën rreth 42.8% të kredisë në valutë të sektorit bankar.

Grafik 1: Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Nivelet e rrezikut për secilin tregues, përcaktohen duke iu referuar një pragu krahasues. Për treguesit e 'depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave' dhe 'kreditë në valutë ndaj totalit të tepricës së kredisë', pragu krahasues është niveli prej 30%, sipas gjykimit ekspert. Për vlera nën 30% të këtyre treguesve, niveli i rrezikut konsiderohet 'i ulët' (ngjyra e gjelbër). Për treguesin e 'aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë', pragu krahasues llogaritet duke i shtuar një devijim standard të serisë kohore kufirit rregullativ prej 20%. Për vlera më të ulëta se ky prag krahasues, treguesi sinjalizon 'nivel të lartë' të rrezikut. Për treguesin e 'depozitave me afat deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë', pragu krahasues është përcaktuar sipas gjykimit ekspert në nivelin 60%.

⁵ Treguesit e monitoruar në këtë raport, paraqiten të zhveshur nga efekti i luhatjeve në kursin e këmbimit të monedhës kombëtare ndaj monedhave kryesore të huaja (euro dhe dollarë amerikanë), duke marrë si periudhë bazë dhjetorin e vitit 2017, përpara se masat të hynin në fuqi.


III Ecuria e treguesve

Në këtë kapitull analizohet ecuria e treguesve të prezantuar në hyrje të raportit. Paraqitja e treguesve pa efektin e kursit të këmbimit synon matjen e efektit të masave pa ndikimin e ecurisë së kursit. Ashtu siç është paraqitur në vijim, lajmërimi i paketës së masave nuk ka pasur ndikim të menjëhershëm mbi treguesit e analizuar.

Ecuria në DEPOZITA:

Në fund të gjashtëmuajorit të parë 2018, depozitat në valutë arritën në 53.2% të totalit të depozitave, krahasuar me 52.3% që ishte në fund të dhjetorit 2017 dhe 53.4% një vit më parë. Me përjashtim të fundit të vitit 2017, ky tregues rezulton të jetë luhatur rreth nivelit 53%.


Grafik 2: Raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket shpërndarjes së treguesit të depozitave në valutë, vërehet se gjysma e bankave të sektorit e kanë këtë tregues mbi 50%, duke i bërë ato objekt të rezervave më të larta për pjesën mbi 50% (Grafiku 3, më poshtë).


Grafik 3: Shpërndarja e treguesit të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesë e paketës së masave është dhe reduktimi i kërkesës për rezervë për depozitat që janë me maturim mbi një vit. Në fund të qershorit 2018, depozitat deri në një vit në monedhën vendase ishin 87.4% e totalit të depozitave në lekë, nga 86.4% që shënonte gjashtë muaj më parë. Ecuria e treguesit paraqitet në grafikun në vijim.


Grafik 4: Raporti i depozitave deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas bankave, shpërndarja e treguesit të mësipërm paraqitet jo e njëtrajtshme. Vërehet një rritje e numrit të bankave që kanë shtuar peshën e depozitave në lekë mbi një vit si përqindje e totalit të depozitave në monedhën vendase. Rritja e depozitave mbi një vit ndihmon në përmirësimin e qëndrueshmërisë së burimeve të financimit të sektorit bankar.

Grafik 5: Shpërndarja e raportit të depozitave deri në një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria në AKTIVET LIKUIDE:

Sektori bankar karakterizohet nga nivele të kënaqshme të likuiditetit, konkretisht të treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra. Në nivel sektori, ky tregues ka ruajtur vlera mbi kufijtë rregullatorë si për monedhën vendase ashtu dhe për atë në valutë, duke ndikuar pozitivisht në shëndetin e sistemit financiar.

Në lidhje me shpërndarjen e treguesit sipas bankave të sistemit, vërehet se të gjitha bankat (me përjashtimin e ndonjë periudhe) paraqiten mbi nivelin e kërkuar rregullator. Treguesi i aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë paraqet interes të veçantë, pasi pjesë e paketës së masave të lartpërmendura ishte dhe rritja e kufirit rregullator për këtë tregues, nga 15% në 20%. Për më shumë në lidhje me shpërndarjen e treguesit sipas bankave të sektorit, referojuni grafikut në vijim.

Grafik 6: Shpërndarja e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria në KREDI:

Në tepricën e kredive të sektorit bankar, mbizotërojnë kreditë në valutë. Prirja rënëse ka ndryshuar gjatë gjashtëmujorit të fundit. Në fund të qershorit 2018, kreditë në valutë ndaj totalit shënonin 57.2%, me rritje prej 0.6 pikë përqindjeje krahasuar me gjashtë muaj më parë.


Grafik 7: Raporti i kredive në valutë ndaj totalit të kredive për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e treguesit është ndikuar nga ngushtimi i kuartil të dytë, ndërkohë që kuartili i tretë është zgjeruar dukshëm. Nga ana tjetër, vlen të theksohet që mediana ka qëndruar thuhajse e pandryshuar. Në vijim paraqitet shpërndarja e treguesit për bankat e sistemit.


Grafik 8: Shpërndarja e raportit të kredisë në valutë ndaj totalit të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndër kreditë në valutë, kreditë më të ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit janë ato ku subjekti huamarrës i ka të ardhurat në monedhë të ndryshme nga monedha e kredisë (kreditë e pambuluara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit). Në fund të qershorit 2018, këto kredi përbëjnë 42.8% të kredive në valutë, krahasuar me 43.5% gjashtë muaj më parë. Rënia e treguesit është sinjal pozitiv që pasqyron reduktimin e ekspozimit të sistemit financiar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.


Grafik 9: Raporti i kredisë në valutë të pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit ndaj totalit të kredisë në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e treguesit të kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit për bankat e sektorit paraqitet në grafikun në vijim. Vërehet një shpërndarje e gjerë e treguesit, ku gjysma e vlerave të tij luhaten në intervalin midis 46.6% dhe 69.9%. Shpërndarja e gjerë e treguesit reflekton faktin që disa banka janë më të ekspozuara ndaj rrezikut indirekt të kursit të këmbimit.

Grafik 10: Shpërndarja e peshës së kredisë në valutë të pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit ndaj totalit të kredisë në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Ecuria në BORXHIN PUBLIK:

Në fund të muajit mars 2018⁶, vërehet:

- 1) rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet më të gjatë se 12 muaj;
- 2) rënie e peshës së detyrimeve në valutë të qeverisë shqiptare.

Rënia e detyrimeve në valutë dhe rritja e atyre në monedhën vendase, ndikon pozitivisht në drejtim të deeuroizimit. Krahasuar me fundin e vitit 2017, pesha e borxhit publik në monedhën vendase u rrit me 1.1 pikë përqindje, duke shënuar 51.9% në fund të tremujorit të parë 2018. Borxhi i brendshëm është i denominuar kryesisht në lekë, ndërsa borxhi i jashtëm mbahet në monedha të ndryshme, por më së shumti në monedhën e përbashkët evropiane.

Grafik 11: Ecuria e borxhit publik në lekë dhe valutë, si dhe pesha e borxhit publik në lekë ndaj totalit




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

⁶ Të dhënat më të fundit të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë i referohen fundit të muajit mars 2018.

Ecuria në KURSIN E KËMBIMIT:

Gjatë gjashtëmujorit të kaluar ka vijuar forcimi i monedhës vendase kundrejt monedhave kryesore, euro dhe dollar amerikan. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018, monedha vendase ka vijuar prirjen e lehtë forcuese kundrejt euros; ndërsa, kundrejt dollarit amerikan, luhatshmëria ka qenë më e lartë, duke reflektuar përgjithësisht ecurinë e kursit të këmbimit të dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare të monedhave.

Grafik 12: Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dy monedhave kryesore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Stabiliteti makroekonomik shoqërohet zakonisht me qëndrueshmëri të kursit të këmbimit. Në përgjithësi, kjo ecuri duhet të mbështesë besimin e publikut në monedhën kombëtare dhe të rrisë përdorimin e saj në veprimtarinë e agjentëve të ekonomisë në afatin e gjatë. Nga ana tjetër, prirja afatgjatë nuk përjashton luhatshmërinë e kursit të këmbimit në periudha të caktuara, duke ndikuar në vlerën e kursimeve dhe të huamarrjes në valutë. Nga ky këndvështrim, kjo luhatshmëri vlen për të sinjalizuar përdoruesit e valutës mbi rreziqet që shoqërojnë vlerën e ekspozimit të tyre dhe nevojën për vlerësimin e kujdesshëm dhe ndërmarrjen e veprimeve për zbutjen e këtyre rreziqeve.

Referuar treguesve të përmendur më sipër dhe ecurisë së kursit të këmbimit, rezulton që paketa e masave nuk ka pasur efekt mbi kursin e këmbimit. Pas prezantimit të masave në shkurt të këtij viti, treguesit kryesorë për analizimin e efektit të paketës së masave nuk paraqesin ndryshime domethënëse.

IV Konkluzione

Bazuar në ecurinë e gjashtëmujorit të parë 2018, vërehet një rritje e lehtë e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, nga niveli 52.3% në 53.2%. Niveli aktual i raportit të depozitave në valutë të sektorit privat, ndaj totalit të depozitave pranë sektorit bankar, vijon të jetë dukshëm më i lartë se niveli mesatar i këtij raporti për vende me ekonomi të ngjashme si Shqipëria. Ndërkohë, portofoli i kredisë për sektorin privat ka njohur rritje të lehtë të peshës së kredisë në valutë. Megjithëse kredia e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit ka njohur rënie gjatë periudhës, ajo vijon të ketë një peshë të konsiderueshme në portofolin e kredisë në valutë.

Borxhi publik ka ardhur në rritje gjatë viteve të fundit, ku kontributin kryesor e ka dhënë rritja e borxhit në lekë. Kursi i këmbimit të lekut ndaj monedhave kryesore ka vijuar prirjen forcuese të periudhave të mëparshme, i pandikuar nga efekti i masave të deeuroizimit. Ecuria e vlerave të treguesve dëshmon se masat nuk kanë pasur ndikim domethënës.

Bazuar në sa më lart, mund të thuhet se sektori bankar shqiptar paraqet nivele të larta të euroizimit, që reflektojnë përdorimin e valutës në shkallë të gjerë në ekonominë vendase. Në këto kushte, marrja e masave për të kontrolluar dhe ulur këto nivele në mënyrë graduale, është e nevojshme.

Për këtë arsye, mbështetur në Memorandumin e Bashkëpunimit, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, do të vijojnë aplikimin e masave për tregjet dhe instrumentet që mbikëqyrin respektivisht, me qëllim nxitjen e përdorimit sa më të gjerë të monedhës vendase në ekonominë shqiptare.

Aneksi I: Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit

Nr.	Masa	Data e adoptimit/e zbatimit	Përshkrim
1.	Kufizimi i huave në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.09.2011 òPër administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huajaö.	Huatë në valutë, të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra kur të ardhurat e huamarrësit janë në lekë) nuk duhet të kapërcejnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel, zbritet nga vlera e kapitalit rregullator.
2.	Kërkesa minimale për aktive likuide në valutë	Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 26.10.2011, dhe nr. 28, datë 27.03.2013.	Vendosja e një kërkesë minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan), dhe në total në nivelin 20%.
3.	Kërkesa më e lartë për kapital, lidhur me huatë në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.07.2013 òPër raportin e mjaftueshmërisë së kapitalitö.	Huatë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ponderohen me koeficient më të lartë rreziku (150%) për qëllime të llogaritjes së treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.

Aneksi II: Vrojtimi i kryer për euron nga Banka Qendrore e Austrisë

Banka Qendrore e Austrisë (Oesterreichische Nationalbank, shkurt OeNB) kryen periodikisht vrojtme në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore në lidhje me nivelin e përdorimit të monedhës euro krahasuar me monedhat e vendeve që janë pjesë e vrojtimit. Ky vrojtım ka nisur që në vitin 2007 dhe krahason nivelin e euroizimit për kategoritë në vijim: euroizimi i aktiveve, euroizimi i detyrimeve, besimi dhe pritshmëritë e individëve ndaj euros dhe monedhës vendase, si dhe niveli njohurive financiare të individëve. Aktualisht vrojtimi i OeNB-së kryhet në dhjetë vende, ndër të cilat gjashtë janë anëtare në BE⁷ dhe katër nuk janë anëtare⁸.

Deri në vitin 2014 vrojtimi kryhej dy herë në vit dhe duke filluar nga viti 2015 frekuenca u reduktua në një herë në vit. Për kryerjen e vrojtimit përzgjidhen në mënyrë rastësore 1000 persona prej secilit vend dhe intervistohen. Kampioni i përzgjedhur përfaqëson popullatën e individëve mbi 15 vjeç në bazë të moshës, gjinisë dhe fesë, sipas shpërndarjes gjeografike.

Në kuadër të raportit të deeuroizimit, kemi përzgjedhur të evidentojmë disa tregues që lidhen me vlerësimin e besimit dhe pritshmërive të individëve ndaj monedhës vendase, si dhe me nivelin e njohurive të tyre financiare. Në vijim paraqiten treguesit e publikuar nga OeNB në faqen e tyre zyrtare.⁹

Besimi dhe pritshmëritë e individëve

Vrojtimi mat besimin e individëve ndaj euros, monedhës vendase, si dhe bën krahasimin mes tyre. Ai adreson besimin e individëve ndaj institucioneve, si BE-së, institucioneve shtetërore në vendet përkatëse, si dhe ndaj bankave. Gjithashtu, vrojtimi ndjek pritshmëritë e individëve për situatën ekonomike në vendet ku ata janë rezidentë dhe për situatën financiare në familjet e tyre.

Në përgjithësi, individët në Shqipëri kanë relativisht më shumë besim ndaj BE-së, institucioneve shtetërore dhe ndaj bankave, duke u renditur të parët për besimin e tyre, krahasuar me vendet e tjera pjesëmarrëse në vrojtım. Gjithashtu, individët në Shqipëri kanë më shumë besim se vendet e tjera që depozitat e tyre janë të sigurta.

Për sa i përket besimit ndaj euros dhe monedhës vendase, individët në Shqipëri besojnë që monedha vendase do të jetë e qëndrueshme dhe e besueshme në pesë vitet e ardhshme, siç paraqitet në grafikun në vijim.


⁷ Vendet anëtare në BE të përfshira në vrojtım: Bullgaria, Kroacia, Polonia, Rumania, Republika Çeke, dhe Hungaria.

⁸ Vendet që nuk janë anëtare në BE janë: Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia.

⁹ Rezultatet e vrojtimit mund të gjenden në faqen në vijim:

<https://www.oenb.at/Geldpolitik/Erhebungen/OeNB-Euro-Survey.html>

Grafik 13. Besimi në monedhën vendase sipas vendeve anëtare të BE-së (grafiku në të majtë); dhe vendeve kandidate apo potenciale për kandidate (grafiku në të djathtë)




Burimi: Vrojtimi për Euron nga OeNB.

Shënim: Për llogaritjen e ecurisë janë përdorur mesataret e kampionit të secilit vend (-2.5 “jam plotësisht kundër,” 0 “jam neutral,” +2.5 “jam plotësisht dakord”). Të anketuarit u pyetën nëse janë apo jo dakord sipas shkallës 1 (plotësisht dakord) deri në 6 (plotësisht kundër) në lidhje me pyetjen: “Sa dakord jeni me shprehjen në vijim: Në pesë vitet e ardhshme monedha vendase do të jetë shumë e qëndrueshme dhe e besueshme”.

Megjithatë, kur u kërkohej të krahasojnë midis euros dhe monedhës vendase, individët më së shumti përzgjedhin monedhën euro si më të besueshme dhe të qëndrueshme në të ardhmen. Në rastin e Shqipërisë vërehet një trend përmirësues ku diferenca mes monedhës vendase dhe euros po ngushtohet duke shënuar nivele më të ulëta dhe të krahasueshme me vendet e tjera të rajonit.

Grafik 14. Niveli relativ i besimit ndaj euros në krahasim me monedhën vendase për vendet anëtare të BE-së (grafiku në të majtë); dhe vendet kandidate apo potenciale kandidate (grafiku në të djathtë)



Burimi: Vrojtimi për Euron nga OeNB.

Shënim: Për llogaritjen e ecurisë janë përdorur mesataret e kampionit të secilit vend (-2.5 “jam plotësisht kundër,” 0 “jam neutral,” +2.5 “jam plotësisht dakord”). Të anketuarit u pyetën nëse janë apo jo dakord sipas shkallës 1 (plotësisht dakord) deri në 6 (plotësisht kundër) në lidhje me pyetjen. “Sa dakord jeni me shprehjen në vijim: “Në pesë vitet e ardhshme, euro/monedha vendase do të jetë shumë e qëndrueshme dhe e besueshme.”

Vlerat pozitive tregojnë që vlerësimi i stabilitetit dhe besueshmërisë në monedhën euro në krahasim me monedhën vendase është relativisht më e lartë.


Njohuritë financiare të individëve në Shqipëri

Për vlerësimin e njohurive të individëve në secilin vend, vrojtimi përdor një metodë standarde të aplikuar gjerësisht edhe nga vende të tjera.¹⁰ Vrojtimi adreson njohuritë e individëve në katër dimensione: normat e interesit, norma e inflacionit, kursi i këmbimit dhe rreziqet financiare.

Sipas vrojtimit, individët në Shqipëri kanë njohuri relativisht të kënaqshme përsa i takon rrezikut financiar. Ndërkohë, ata paraqiten relativisht të kufizuar në drejtim të njohjes së rrezikut të kursit të këmbimit, të normës së interesit dhe inflacionit. Për më shumë informacion referojuni grafikëve në vijim.

Grafik 15. Niveli i njohurive për normën e interesit sipas vendeve

(mesatarja 2011 – 2017, si % e përgjigjeve)




Burimi: Vrojtimi për Euron nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është “Supozoni që keni 100 [në monedhë vendase] në llogari kursimi dhe norma e interesit ishte 2% në vit. Duke injoruar çdo tarifë tjetër bankare, sa do të keni në llogarinë tuaj pas 5 viteve nëse do t’i linit paratë të shtoheshin në llogari: më shumë se 102, ekzaktësisht 102, më pak se 102 [në monedhë vendase].”

¹⁰ Metoda e përdorur është prezantuar për herë të parë nga Lussardi dhe Mitchell “Financial Literacy and Planning: Implications for Retirement Wellbeing, 2004.

Grafik 16. Niveli i njohurive për inflacionin sipas vendeve

(mesatarja 2011 – 2017, si % e përgjigjeve)




Burimi: Vrojtimi për Euron nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është “Supozoni që norma e interesit në llogarinë tuaj të kursimit ishte 4% në vit dhe inflacioni 5% në vit. Sërish duke injoruar çdo tarifë tjetër bankare – pas 1 viti, do të mund të blini më shumë, ekzaktësisht njësoj, apo më pak se sot me paratë në këtë llogari?” Janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.

Grafik 17. Niveli i njohurive për kursin e këmbimit sipas vendeve

(mesatarja 2011 – 2017, si % e përgjigjeve)




Burimi: Vrojtimi për Euron nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është “Supozoni që keni marrë një kredi në euro. Më pas kursi i këmbimit për [monedhën vendase] zhvlerësohet kundrejt euros. Si do të ndryshonte shuma në monedhën vendase që të duhet të kryesh për të paguar kështu e kreditë? Paga e kështu rritet / qëndron e pandryshuar / ulet. Janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.

Grafik 18. Niveli i njohurive për rrezikun financiar sipas vendeve

(mesatarja 2011 – 2016, si % e përgjigjeve)



Burimi: Vrojtimi për Euron nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është “Kur një investitor shpërndan paratë e tij në aktive të ndryshme, në këtë rast rreziku për të humbur para rritet / ulet / nuk ndryshon?” Janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.